



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Proces verbal

Sot me datë 22.05.2025 ora 13:30 ishte parashikuar mbledhja e **Kryesisë së Këshillit Bashkiak** për shqyrtimin e rendit të ditës për mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak.

Të pranishëm janë:

Z. Oltion Luli
Z. Gjergj Sokoli
Znj.Valjeta Bajraktari

Mungon:

Znj. Irena Shala
Znj. Violeta Perndrecaj
Z. Edmond Ndou

Kourumi i domosdoshëm për zhvillimin e mbledhjes nuk është prezent, prandaj **Z.Luli** në cilësinë e Kryetarit sqaron se kjo mbledhje do jetë vazhduese e mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak, dhe se rendi i ditës do të jetë i njëjtë me atë të datës: 08.04.2025. Po ashtu **Z.Luli** vendos edhe për datën e mbledhjes , e cila do të mbahet ditën e Enjte, datë 29.05.2025 ora 17:00 me rend dite si më poshtë:

1. *Projektvendim: “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit tip ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe distributorëve vendas dhe të huaj për shfaqjen e prodhimeve audiovizuale në Kinema “Republika”.*
2. *Projektvendim: “Për miratimin e kërkesës për transferim në pronësi, të pasurisë me Nr.2/170, Vol 9, faqe 140, ZK 8591 nga Ministria e Financave tek Bashkia Shkodër ”.*
3. *Projektvendim : “ Për dhënie pëlqimi, shtesa dhe ndryshime për shoqërinë aksionare “Bio Strajca”, në pronësi të Bashkisë Shkodër”*
4. *Projektvendim: “Për dhënien e të drejtës dhe caktimin e përgjegjësisë së menaxhimit, administrimit dhe mirëmbajtjes së plazheve publike të menaxhueshme për shoqërinë aksionere në pronësi të Bashkisë Shkodër me nipt M36924003O ”.*
5. *Projektvendim: “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 e miratuar VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar dhe detajim të fondeve sipas aktit normativ Nr.5 datë 19.12.2024 të Ministrisë së Financave”.*
6. *Projektvendim: “Për miratimin e planit “Për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në Bashkinë Shkodër për vitin 2025”.*
7. *Projektvendim: “Për miratimin e “Planit të përbashkët të menaxhimit të rrezikut nga zjarri” në kuadër të projektit “ Bulding Smart Forests” .*

8. *Projektvendim: "Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 e miratuar VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar".*
9. *Projektvendim: "Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Shkodër për vitet 2026-2028".*
10. *Projektvendim: "Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Shkodër".*
11. *Projektvendim: "Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2024 të Bashkisë Shkodër".*
12. *Projektvendim: " Për miratimin e memorandumit të bashkëpunimit mbështetje për zhvillim 2023-2024 projekti "Bashki të forta"- Bashkia Shkodër"*
13. *Projektvendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Prill 2025".*
14. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Zbardhi Proces verbalin:

Irma Sulishti



SEKRETARE

Sabina DANAJ

